



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

<b>DATË/A:</b>	15.11.2024
<b>REFERENCË:</b>	Nr. 02-060/01-0073080-5/24
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Bedri Hamza - Kryetar i Komunës
<b>CC:</b>	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Vesa Broja - Kryesuese e Kuvendit të Komunës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Draft-Rregullore për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 15.11.2024, pasi shqyrtoi Draft-Rregulloren për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, sjellë këtë:

### **Konkluzion**

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Draft-Rregulloren për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.
2. Draft-Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

**SHTOJCË:** *Draft-Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	14.11.2024
REFERENC-Ë:	02-110/25-0074202
PËR/ZA/TO:	znj. Vesa BROJA, Kryesuese e Kuvendit të Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa,
PËRMES/PREKO/THROUGH	z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Komisioni për Hartimin e Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, znj. Teuta SELMANI PLLANA – Kryotare e Komisionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim për Miratim të Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale

Bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenin 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020), nenet 26 dhe 27 të Rregullore (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kryetari i Komunës i propozon, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës këtë:

### PROPOZIM

(Për Miratimin e Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale)

1. I propozohet Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa që të miratojë Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

### ARSYETIM

Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0064559/24, dt. 27.09.2024, ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft – Rregullore për Plotësim-Ndryshimin e Rregullore Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, ku ky Komision ka përfunduar Draftin Final të Rregullore së

lartcekur, konform Vendimit për Emërimin të tij, dhe dispozitave ligjore në fuqi për hartim të tij.

Pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara ligjore për hartimin e këtij Drafti, dhe duke u bazuar në të thënat e lartcekura, i propozojmë Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa që të miratoj këtë Draft - Rregullore.

**Shtojcë:**

**1x1** Draft – Rregullorja për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	12. 11. 2024
REFERENCË:	02-110/05-0073744/24
PËR/ZA/TO:	znj. Vesca BROJA - Kryesuese e Kuvendit të Komunës z. Bedri HAMZA - Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Nazmi JASHARI - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
NGA/OD/FROM:	znj. Teuta SELMANI PLLANA - Kryetare e Komisionit për Hartimin e Draft - Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga Konsultimi Publik për Draft - Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale

### Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenin 32, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komisioni ka shpall Diskutimin Publik për Draft - Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, për datën 11.11.2024, në Sallën e Mediave të Komunës, duke filluar nga ora 10:00 h.

### Ecuria e procesit

Komisioni në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, ka publikuar Njoftimin për Konsultim Publik të Draft - Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale në ueb faqen e Komunës 8 (tetë) ditë para mbajtjes së takimit në linkun:

<https://kk.rks-gov.net/mitrovicceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/11/Diskutim-Publik-Draft-Rregullorja-per-Ndryshim-Plotesim-te-Rregullores-01-2022-per->

[Organizimin-Kompetencat-dhe-Pergjegjesite-e-Administrates-Komunale.pdf](#), në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës (<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42666>), dhe në rrjetet sociale të Komunës.

Njoftimi për Konsultim Publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, respektivisht, nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, duke u interesuar që të sigurohet Njoftim i Plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me Njoftimin për Konsultim Publik palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik. Njoftimit i është bashkangjitur Draft – Rregullorja për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve.

Metodat e Konsultimit	Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	8 ditë para mbajtjes së takimit kryesor	10

Në konsultim publik për Draft – Rregulloren për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale kanë marrë pjesë: Komisioni Punues i Draft – Rregullores për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, Njësia për Komunikim me Publikun, Pjesëmarrës nga Shoqëria Civile, dhe disa nga zyrtarët e drejtorive.

Në këtë Diskutim Publik nuk ka pasur kërkesa për ndryshime shtesë jashtë Draftit të punuar nga Komisioni, përveç që kërkonin sqarime shtesë lidhur me ndryshimet e propozuara në këtë Draft.

Nuk ka pasur pjesëmarrës tjerë.

#### **SHTOJCË:**

*Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik.*





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komuna e Mitrovicës

Nr. 01-060/04-0073590/24  
Mitrovicë

dt. 11.11.2024

## PROCESVERBAL

(I Diskutimit Publik, të mbajtur më datë 11.11.2024 nga Komisioni për hartimin e Draft – Rregullores për Ndryshim-Plotësimin e Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale)

**Në Diskutim Publik morën pjesë:** Kryetarja e Komisionit, dhe Anëtarët e Komisionit, Zyra për Informim e Komunës, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, dhe disa nga Zyrtarët e Komunës.

**Diskutimi Publik filloi në ora:** 10:00 h  
**Përfundoi në ora:** 11:00 h.

Në diskutim publik Kryetari i Komisionit së bashku me Anëtarët u dakorduan që të mbahet dhe një takim që të analizohen disa ndryshime që i kanë dërguar përmes e-mailit pas publikimit të Draftit Final në Ueb faqen e Komunës. Pasi që nuk pati pjesëmarrës të tjerë në takim dhe Komisioni e ka përfunduar obligimin ligjor për mbajtjen e këtij diskutimi, i njëjti vendosi që të mbahet dhe një takim punues i Komisionit për të përfunduar Draftin Final të Ndryshi,-Plotësimin të Rregullores, dhe përfshirjes së ndryshimeve të dërguara nga Drejtoritë Komunale dhe Zyrat në Komunë.

Ky takim u vendos që të mbahet më datë 11.11.2024, në orën 14:00 h, me ç'rast dhe do të finalizohet ky Draft.

Takimi përfundoi në ora 11:00 h.

### Pjesëmarrësit e takimit:

  
Teuta Selmani Pllana

  
Gëzim Stavileci

  
Lavdim Musa

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik për Hartimin e Ndryshim – Plotësimin e Draft - Rregullores për Organizimin,  
Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, i mbajtur më datë 11.11.2024, në ora 10:00 h

Nr.	Emri/Mbiemri	Pozita /Org.	Tel	Email	Signature
1.	Laudiar NO SA	J.J. NECAJHER BORNIMEVE NE	349-566 019	laudiar.necajher@rks-gov.net	
2.	Sofije Lushtin-Peci	Ejrtare per Internim	044277880	sofije.lushtin@rks-gov.net	
3.	Ferhije Kabashi	Koordinator Gjergj/SCIK	044118517	ferhije.kabashi@rks-gov.net	
4.	MIRANDA VORFAJ	ZYRTARE OPERACION EVE TE REAGIMIT	0451480-888	MIRANDA.V.GASHI@rks-gov.net	
5.	Tertza Selman Pllana	Zyrtare Ligjore	045-807-920	tertza.selman@rks-gov.net	
6.	Bukurrije Ullmani	Zyrtare Ligjore	044540835	bukurrije.ullmani@rks-gov.net	
7.	Albana Fejza	Zyrtare ligjore	049/242-771	albana.fejza@rks-gov.net	
8.	Valbona Peci	Zyrtare	049-384-118	valbona.peci@rks-gov.net	
9.	Xhëvdiza Kallaci	OSCE	049 956900	—	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Nr.	Emri/Mbiemri	Pozita /Org.	Tel	Email	Signature
10	Gezim Stevica	Prerori	049/225 970	Gezim.stevica@opstina-juzna-mitrovica.gov.kg	





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	01-11-2024
REFERENCË:	04-030/23 - 0071769/24
PËR/ZA/TO:	znj. Blerida Kastrati Idrizi - Udhëheqëse e Njësisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit
Ce:	z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Teuta Selmani Pllana - Kryetare e Komisionit për Hartim e Ndryshim - Plotësim të Draft - Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallje e Diskutimit Publik

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe Vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020; Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit e Akteve të Komunës; nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna shpall:

### DISKUTIM PUBLIK

(Për Hartim të Draft – Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale)

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultim Publik, i cili do të mbahet ditën e hënë, me datë 11.11.2024, në Sallën e Mediave të Komunës, duke filluar nga ora 10:00 h.

Duke pasur parasysh rëndësinë e Hartimit të Draft – Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, pjesëmarrja në këtë fazë të procesit është e nevojshme, prandaj të gjithë të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij Njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet dhe sugjerimet mund t'i japin përmes e-Mail adresave elektronike tek Kryetarja e Komisionit për Hartimin e Draftit të Rregullores: [teuta.selmani@ark-gov.net](mailto:teuta.selmani@ark-gov.net).

Bashkangjitur gjeni Draft-Rregulloren për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Page | 1

**RREGULLORE NR. \_\_\_\_/\_\_\_\_,**  
**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 01/2022**  
**PËR**  
**ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS**  
**KOMUNALE**

**Nëntor, 2024**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

Page | 2

Nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_  
Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregullorës (MAPL) Nr. 02-2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin të Akteve të Komunës, nenin 13, paragrafi 1.3 Nr 02-060/01-0056607/20-4 dt.24.09.2020 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë \_\_\_\_\_, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. \_\_\_\_ / \_\_\_\_\_,**  
**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORËS NR. 01/2022**  
**PËR**  
**ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATËS**  
**KOMUNALE**

Nëntor, 2024

## **Neni 1**

Kjo Rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

## **Neni 2**

Page | 3

Neni 2, paragrafi 2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

2. Komuna kryen punë dhe detyra përmes drejtorive të administratës komunale, zyrave, njësisve, sektorëve dhe institucioneve vartëse të saj, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe dispozitave pozitive.

## **Neni 3**

Neni 4, të Rregullores bazë i shtohet një paragrafi i ri, dhe atë paragrafi 6, si në vijim:

6. Me punën e Institucioneve vartëse udhëheq Drejtori i Institucionit, dhe puna e tij është e rregulluar me ligjet dhe aktet nënligjore dhe me Statutin e Institucionit.

## **Neni 4**

Neni 8, paragrafi 1.10 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

## **Neni 5**

Neni 18 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

## **Neni 6**

Neni 19, tek paragrafi 1.12 i Rregullores bazë fshihet emërtimi “Pyjeve”.

## **Neni 7**

Neni 28, tek paragrafi 1.2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1.2 Sektori për Administratë në Shëndetësi.

## **Neni 8**

Neni 30, i Rregullores bazë emërtimi “Sektori për Administratë dhe Financa në Shëndetësi” zëvendësohet me fjalinë “Sektori për Administratë në Shëndetësi”.

## **Neni 9**

Neni 32, tek paragrafi 1.2 i Rregullores bazë fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1.2 Sektori për Administratë në Arsim.

## **Neni 10**

Neni 33 i shtohet një paragraf i ri, paragrafi 1.18:

1.18 Në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së dhe Sektorin për Administratë përpunon kërkesat dhe nevojat e shkollave për stafin edukativo arsimor dhe mbështetës dhe në bashkëpunim me sektorin e administratës planifikojnë konkurset e rregullta dhe plotësuese në fillim të vitit shkollor, për vitin vijues shkollor.

Page | 4

#### **Neni 11**

Neni 34, i Rregullores bazë emërtimi “Sektori për Administratë dhe Financa në Arsim” zëvendësohet me fjalinë “Sektori për Administratë në Arsim”, dhe këtij neni i shtohet paragrafi 1.10:

**1.10** Në bashkëpunim me drejtorin e DKA-së dhe Sektorin për Zhvillimin e Arsimit përpunon kërkesat dhe nevojat e shkollave për stafin edukativo arsimor dhe mbështetës dhe në bashkëpunim me sektorin e administratës planifikojnë konkurset e rregullta dhe plotësuese në fillim të vitit shkollor, për vitin vijues shkollor.

#### **Neni 12**

Neni 75 i Rregullores bazë, fshihet emërimi “Pyjeve”.

#### **Neni 13**

Neni 78 i Rregullores bazë fshihet në tërësi.

#### **Neni 14**

Pas neni 89 shtohen 2 nene të reja dhe atë:

#### **Neni 89A**

#### **Sektori i Shërbimeve Sociale**

1. Sektori i Shërbimeve Sociale kryen këto detyra dhe përgjegjësi:
  - 1.1 Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin e Qendrës për Punë Sociale dhe sipas kërkesës për Udhëheqësin më të Lartë Administrativ të Institucionit;
  - 1.2 Kontribon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes;
  - 1.3 Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
  - 1.4 Trajton rastet dhe përgatit raport për gjykatën, për heqjen e zotësisë se veprimi të personave të paaftë për të vepruar;
  - 1.5 Trajton mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësimin, kujdestarinë dhe strehimin e përkohshëm familjar;
  - 1.6 Trajton rastet e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikuede, rastet e angazhimit të fëmijëve në punët e rënda dhe të lënies pa kujdes;
  - 1.7 Monitoron rastet e dhunës në familje dhe angazhohet në përmirësimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe bënë propozimin për besimin e fëmijëve në raste të shkurorëzimit të prindërve dhe përcjell realizimin e kontaktimeve;



- 1.8 Përkujdeset edhe për kategoritë tjera të personave me nevojë, të moshuarit, fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme, personave që konsumojnë substanca narkotike, alkoolike etj;
- 1.9 Vlerëson statusin zhvillimor, psikologjik, emocional dhe të sjelljes së fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve bazuar në matjet psikologjike të standardizuara, teknikat projektuese dhe vendimet tjera profesionale, vlerëson nevojat e familjeve dhe përcakton në bashkëpunim të ngushtë me familjet, llojet e shërbimeve;
- 1.10 Punë këshillëdhënëse me familjet dhe fëmijët në fushën e mirëqenies sociale dhe kujdesit për fëmijë;
- 1.11 Përkrah procesin e hartimit të planeve familjare të zhvillimit dhe punë me fëmijët dhe familjet bazuar në ato plane;
- 1.12 Jep ndihmë prindërve, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve;
- 1.13 Organizon aktivitetet rekreative dhe edukative për fëmijë, të rinjë dhe familje;
- 1.14 Terapi Individuale, familjare dhe grupe;
- 1.15 Identifikon burime të mundshme të ndihmës nga komuniteti;
- 1.16 Siguron zbatimin e të gjitha parimeve dhe procedurave që dalin nga Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe vepron në përputhje me to.

### **Neni 89B** **Sektori i Skemës së Ndhimave Sociale**

1. Sektori i Skemës së Ndhimave Sociale kryen këto detyra dhe përgjegjësi:
  - 1.1. Mbështetë dhe ofron këshilla për Drejtorin e Qendrës për Punë Sociale dhe sipas kërkesës për Udhëheqësin më të Lartë Administrativ të Institucionit, për fushën e përgjegjësisë së sektorit që udhëheq;
  - 1.2. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes;
  - 1.3. Bën procedimin e aplikacioneve të palëve që aplikojnë për ndihma sociale dhe verifikon informacionet e dhëna me kriteret e pranimit;
  - 1.4. Shpjegimi i kriterëve dhe procedurave për aplikantët dhe lëshimi i fletë-aplikacioneve për palët e interesuara;
  - 1.5. Janë përgjegjës që të pranojnë fletë-aplikacionet e plotësuara në tërësi të shoqëruara me të gjitha dokumentet përcjellëse të nevojshme;
  - 1.6. Futja e informacioneve të aplikantit në bazën e të dhënave;
  - 1.7. Përgatitja dhe dërgimi i aplikantëve në komisionin mjekësor;
  - 1.8. Shqyrtimi i aplikacioneve në kohën e duhur dhe marrja e vendimeve në bazë të kriterëve që i përcakton Ligji i S.A.S ( Skemës së Asistencës Sociale);
  - 1.9. Llogaritja e saktë e ndihmës që duhet ti ndahet familjes në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj;
  - 1.10. Mbajtja e sistemeve efikase të dosjeve, dhe përfshirja e dokumenteve të reja dhe futja e tyre në dosje.

### **Neni 15**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullorje është Lista e Klasifikimit të Pozitave për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

## Neni 16

Kjo rregullore shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Page | 6

Kryesuesja e Kuvendit

---

Vesa BROJA

## Teuta Selmani

---

**From:** Teuta Selmani  
**Sent:** Tuesday, November 12, 2024 9:22 AM  
**To:** Bekim Sadiku  
**Cc:** Bedri Hamza; Lavdim Musa; Zenel Citaku; Gezim Stavileci; Lulzim Hajra  
**Subject:** RE: Përshëndetje!

I nderuar, pas takimit të mbajtur me anëtarët e Komisionit për hartimin e Draft – Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, dhe pas shqyrtimit të propozimeve nga ana juaj ju njoftojmë si në vijim:

Sa i përket Rekomandimeve numër 1 dhe 2 të dërguara nga ju, struktura e tyre mund të ndryshojë me Kërkesën e Njësive Përgjegjëse të cilat kanë qenë të njoftuara për ndryshimin e Rregullores, mirëpo nuk kemi pranuar Kërkesë për ndryshim nga ana e tyre. Ndërsa, sa i përket Rekomandimit numër 3, për vendosjen e Sektorit për Integritet Evropian në kuadër të Organizimit dhe Përbërjes së Zyrës së Kryetarit të Komunës, ju njoftojmë se Rregullorja Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian, e cila Rregullore ka rregulluar që kjo Zyrë të themelohet në kuadër të Zyrës së Kryetarit, është shfuqizuar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/109, dt. 23.11.2022, pas analizës juridike për vlerësimin e bazës ligjore dhe nënligjore për aktet e nxjerra nga kjo Qeveri.

Ju faleminderit për angazhimin dhe kontributin tuaj, dhe komentet e dërguara për hartimin e këtij Drafti.

Me respekt,

---

Teuta Selmani  
Zyrtare Ligjore – Zyra Ligjore  
Komuna e Mitrovicës  
Email: [teuta.selmani@rks-gov.net](mailto:teuta.selmani@rks-gov.net)

**From:** Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>  
**Sent:** Wednesday, November 6, 2024 3:48 PM  
**To:** Teuta Selmani <Teuta.Selmani@rks-gov.net>  
**Cc:** Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Gezim Stavileci <Gezim.Stavileci@rks-gov.net>  
**Subject:** FW: Përshëndetje!

Të nderuar,

*Bashkangjitur e gjeni Drafti Rregulloren e Asociacionit të Komunave për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës.*

Fillimisht ju falenderoj për punën në Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, si dhe për mundësinë e ofruar për të dhënë rekomandimet dhe sugjerimet në Draftin final të Rregullores në fjalë.

Ndjejë obligim ligjor që të j'u përcjellë në mënyrë kronologjike punën dhe angazhimin e Kolegjiumit të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës në lidhje me obligimin ligjor për ndryshim-plotësimin e Rregulloreve për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Në kuadër të detyrës zyrtare, si anëtar i Kryesisë së Kolegjiut të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në vitin 2023 kemi zhvilluar shumë takime në lidhje me Ndryshim – Plotësimin e kësaj Rregulloreje, takime të cilat në dhjetor të vitit 2023 janë konkretizuar me një punëtori tre (3) ditore në qytetin e Durrësit, e që qëllimi kryesor i asaj punëtorie ka qenë hartimi i një Drafti unik të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, që do të shërbej për të gjitha Komunitetet e Kosovës, duke i bashkangjitur si pjesë përbërëse Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Pas përfundimit të punëtorisë tre (3) ditore, Asociacioni i Komunave të Kosovës, ka hartuar Draftin Final të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, Draft të cilin u'a ka dërguar të gjithë Kryetarëve të Komunave të Kosovës, në mënyrë që të bëhen ndryshimet e nevojshme sipas nevojave të secilës Komune, **mirëpo si Rregullore duhet ta ruaj Unifikimin e Organizimit të Brendshëm.**

Ne, pas analizimit me kujdes të Draftit final për Ndryshim – Plotësimin e Rregullores Bazë, (brenda afatit të dhënë për sugjerime), konsideroj që të gjitha ndryshim-plotësimet janë bërë sipas nevojave të institucionit.,

**Me qëllim të organizimit sa më të mirë të Institucionit, duke u bazuar në punën e përbashkët të Kolegjiut të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në lidhje me hartimin e një Draft-Rregulloreje, si dhe bazuar në Draftin-Final të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, Draft të cilin e ka hartuar Asociacioni i Komunave të Kosovës., rekomandoj si në vijim;**

1. **Rekomandim;** Të bëhet ndryshim-plotësimi i paragrafit 1.7 të Nenit 8, të Rregullores bazë, (Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kryetarit të Komunës), Ashtu që paragrafi 1.7 i Nenit 8, të fshihet në tërsi nga ky nen, dhe të vendoset si paragraf në kuadër të një neni të ri; Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kuvendit të Komunës;
2. **Rekomandim;** Të bëhet ndryshim-plotësimi i paragrafit 1.4 të Nenit 21, të Rregullores bazë, (Organizimi i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme), Ashtu që paragrafi 1.4 i Nenit 21, të fshihet në tërsi nga ky nen, dhe të vendoset si paragraf i ri, në kuadër të Nenit 8 të Rregullores bazë, (Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kryetarit të Komunës);
3. **Rekomandim;** Të bëhet ndryshim-plotësimi i paragrafit 1.3 të Nenit 40, të Rregullores bazë, (Organizimi i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian), Ashtu që paragrafi 1.3 i Nenit 40, të fshihet në tërsi nga ky nen, dhe të vendoset si paragraf i ri, në kuadër të Nenit 8 të Rregullores bazë, (Organizimi dhe Përbërja e Zyrës së Kryetarit të Komunës).

Ju njoftoj se ndryshimet sipas rekomandimeve të lartcekura si;  
Sekretaria e Kuvendit, të vendoset në kuadër të Organizimit dhe Përbërjes së Zyrës së Kuvendit të Komunës;

Njësia për të Drejtat e Njëriut, të vendoset në kuadër të Organizimit dhe Përbërjes së Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Si dhe Sektori i Integritetit Evropian, të vendoset në kuadër të Organizimit dhe Përbërjes së Zyrës së Kryetarit të Komunës, kanë qenë në kundërshtim me natyrën e punës së këtyre sektoreve, andaj rekomandimet e lartcekura për ndryshim-potësim të këtyre neneve i shërbejnë vendosjes së ligjshmerisë në raport me natyrën e punës së këtyre sektoreve, llogaridhënjes për kryerjen e detyrave të punës, si dhe organizimit të njëjtë me të gjitha Komunitetet e Kosovës.

**From:** Teuta Selmani <Teuta.Selmani@rks-gov.net>

**Sent:** Friday, November 1, 2024 3:38 PM

**To:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>

**Cc:** Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Gezim Stavileci <Gezim.Stavileci@rks-gov.net>

**Subject:** RE: Përshëndetje!

**Me respekt,**

---

Teuta Selmani

Zyrtare Ligjore – Zyra Ligjore

Komuna e Mitrovicës

Email: [teuta.selmani@rks-gov.net](mailto:teuta.selmani@rks-gov.net)

**From:** Teuta Selmani

**Sent:** Friday, November 1, 2024 3:36 PM

**To:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>; Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>

**Cc:** Bedri Hamza <bedri.hamza@rks-gov.net>; Lavdim Musa <Lavdim.Musa@rks-gov.net>; Gezim Stavileci <Gezim.Stavileci@rks-gov.net>

**Subject:** Përshëndetje!

Të nderuar shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbar, Kryetari i Komunës me Vendimin Nr. 01-020/04-0064559/24, dt. 27.09.2024 ka formuar Komisionin për Hartimin e Draft-Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Unë si Kryetare e Komisionit, ju njoftoj se Komisioni ka përfunduar Draftin Final në bazë të rekomandimeve që i kemi marrë nga Drejtoritë/Njësitë përkatëse, të cilin po ju bashkangjesim në attach, së bashku me Rregulloren bazë.

Ju lutem që të analizoni këtë Draft, dhe të na konfirmoni harmonizimin e tij dhe zbatimin e teknikave të aktit secili për fushën e tij, duke përfshirë aspektin ligjor dhe financiar dhe sugjerimet të i dërgoni më së largu deri më datë 06.11.2024 (ditën e Mërkurë) në ora 16:00 h.

Gjithashtu, në këtë Draft nuk kemi mundur të i përfshijmë përshkrimin e detyrave të punës për: Sektorin e Skemës Sociale, Sektorin e Ndhmës Sociale dhe Sektorin e Arkivës, derisa, të njëjtat të plotësohen nga Njësitë Përgjegjëse.

Në emër të komisionit ju falenderojë për angazhimin tuaj.

**Me respekt,**

---

Teuta Selmani

Zyrtare Ligjore – Zyra Ligjore

Komuna e Mitrovicës

Email: [teuta.selmani@rks-gov.net](mailto:teuta.selmani@rks-gov.net)





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0064559 dt. 27.04.2024

Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Kërkesën Elektronike të datës 25.09.2024 nga z. Valon Hetemi – Shef i Kabinetit të Kryetarit, Kryetari i Komunës sjell këtë:

### V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale)

- 1. FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, në këtë përbërje:
  - 1.1** Teuta Selmani Pllana – kryetare (Zyra Ligjore);
  - 1.2** Gëzim Stavileci – anëtar (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme);
  - 1.3** Lavdim Musa – anëtar (Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore).
- 2.** Komisioni është përgjegjës që të bëjë ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, duke bërë harmonizimin e këtyre ndryshimeve në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe dispozitave ligjore pozitive tjera në fuqi.
- 3** Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.
- 4** Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Rregulloren Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat



dhe Përgjegjëstë e Administratës Komunale, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

- 5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi obligohet që të hartojë Draft-Rregulloren në afat më së largu brenda 3 (tre) muajsh, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
- 6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës



Bedri HAMZA



Shtojcë:

1x1 Kërkesa Elektronike e datës 25 09.2024 nga z Valon Hetemi, Shteti i Kosovës

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit



## **Teuta Selmani**

---

**From:** Valon Hetemi  
**Sent:** Wednesday, September 25, 2024 2:11 PM  
**To:** Teuta Selmani; Lulzim Hajra; Bukurije Ujkani

Te nderuar,

Emrat e propozuar per formimin e Komisionit per Plotesim – Ndryshimin e Rregullores per Organizimin e Brendshem te Komunes jane:

1. Teuta Selmani Pllana – Kryesuse
2. Gezim Stavileci - anetar
3. Lavdim Musa - anetar

*Valon Hetemi*

Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut / Chief of the Cabinet at Municipality of Mitrovica South

Komuna e Mitrovicës së Jugut | Municipality of Mitrovica South  
Rr./ Str. "Bedri Gjinaj" Mitrovicë / Mitrovica  
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Mob: +383 (0)49 230 301  
Email: [valon.hetemi@rks-gov.net](mailto:valon.hetemi@rks-gov.net)



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Kryetari i Komunës**

Nr. 01-020/04-0080311/24

Dt. 17.12.2024

Bazuar në nenin 13, nenin 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenin 43 paragrafi 2 të Statutit të Komunës, nenin 38 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës Në Shërbimin Civil, pikën 2 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 08/226 për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sipas propozimit nga Grupi Punues, i themeluar me Vendimin nr. 01-020/04-0047307/24 i datës 15.07.2024, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, sjell këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Klasifikimi i Vendeve të Punës në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Klasa e secilës pozitë përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
3. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Shtojca 1 – Klasifikimi i Vendeve të Punës në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet të cilat e kanë rregulluar këtë çështje.
6. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Kryetari i Komunës ka nxjerr Vendimin paraprak për aprovimin e klasifikimit të vendeve të punës, mirëpo në draftin paraprak janë bërë disa lëshime, andaj me qëllim që të bëhet përmirësimi dhe lista të jetë e harmonizuar me katalogun e vendeve të punës është bërë përmirësimi i saj.

**Bedri HAMZA**

  
Kryetar i Komunës







	<p><b>Zyra ligjore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i zyrës ligjore</li> <li>- Zyrtar i lartë ligjor</li> </ul> <p><b>Zyra e prokurimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i prokurimit</li> <li>- Zyrtar i lartë i prokurimit</li> <li>- Zyrtar i lartë ligjor</li> </ul> <p><b>Sektori për punë të kuvendit komunal</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i sektorit për punë të kuvendit komunal</li> <li>- Zyrtar i lartë për çështjet e kuvendit të komunës</li> <li>- Zyrtar administrativ</li> </ul> <p><b>Njësia e auditimit të brendshëm</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i auditimit të brendshëm</li> <li>- Auditor i brendshëm</li> </ul> <p><b>Zyra komunale për komunitete dhe kthim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i sektorit për komunitete dhe kthim</li> <li>- Zyrtar i lartë për komunitete</li> <li>- Zyrtar i lartë për kthim dhe intergim të komuniteteve</li> <li>- Zyrtar për komunitete</li> <li>- Zyrtar për kthim të qëndrueshëm</li> <li>- Asistent administrativ</li> </ul>	<p>Drejtues i ulët Profesional 1</p> <p>Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 1</p> <p>Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 2</p> <p>Drejtues i ulët Auditor i brendshëm</p> <p>Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 1 Profesional 2 Profesional 2 Profesional 3</p>	<p>Grupi ligjor Grupi ligjor</p> <p>Grupi i prokurimit publik Grupi i prokurimit publik Grupi ligjor</p> <p>Grupi ligjor Grupi ligjor Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>Grupi i auditimit të brendshëm Grupi i auditimit të brendshëm</p> <p>Grupi i administrimit të përgjithshëm Grupi i shkencave shoqërore Grupi i shkencave shoqërore</p> <p>Grupi i administrimit të përgjithshëm Grupi i administrimit të përgjithshëm Grupi i administrimit të përgjithshëm</p>	<p>GJ3 GJ27</p> <p>GJ3 GJ27 GJ27</p> <p>GJ3 GJ27 GJ35</p> <p>W9 W15</p> <p>GJ3 GJ27 GJ27</p> <p>GJ35 GJ35 GJ35 GJ43</p>	<p>1 3</p> <p>1 4 1</p> <p>1 1 1</p> <p>1 2</p> <p>1 1 1 1 1 1</p>
3.	<p><b>DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtor i Drejtorisë</li> <li>- Zyrtar për financa</li> <li>- Zyrtar për mbështetje ligjore</li> </ul> <p><b>Sektori për gjendje civile</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i sektorit për gjendje civile</li> <li>- Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore</li> </ul>	<p>Drejtor i drejtorisë komunale 2 Profesional 2 Profesional 2</p> <p>Drejtues i ulët Profesional 1</p>	<p>Funksionar publik Grupi i buxhetit dhe financave Grupi ligjor</p> <p>Grupi i shkencave shoqërore Grupi ligjor</p>	<p>Y18 GJ35 GJ35</p> <p>GJ3 GJ27</p>	<p>1 1 1</p> <p>1 1</p>

	- Zyrtar për gjendje civile	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	15
	<b>Qendra për shërbime të qytetarëve</b>				
	- Udhëheqës i sektorit për shërbime me qytetarë	Drejtuës i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar për shërbim me qytetarë	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	8
	- Zyrtar për arkiv	Profesional 2	Grupi i arkiv-dokumentacionit	GJ35	3
	- Receptionsist	Teknik dhe mbështetës 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ50	1
	<b>Njësia për të drejtat e njeriut</b>				
	- Udhëheqës i njësisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore	Drejtuës i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1
	- Zyrtar i lartë për barazi gjinore	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	GJ27	1
	- Zyrtar për të drejtat e njeriut	Profesional 2	Grupi i shkencave shoqërore	GJ35	1
	- Zyrtar për të drejta të fëmijëve	Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shërbimeve sociale	GJ35	1
	<b>Sektori për teknologji informative</b>				
	- Udhëheqës i sektorit për teknologji informative	Drejtuës i ulët	Grupi i teknologjisë informative	GJ3	1
	- Zyrtar për teknologji informative	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informative	GJ35	3
	<b>Sektori i punëve të përbashkëta</b>				
	- Udhëheqës i Sektorit	Drejtuës i ulët	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Zyrtar për furnizim dhe transport	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	- Monitorues i kamerave	Profesional 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ43	1
	- Ndihmës punëtor	Teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ50	1
	- Vozitës	Teknik dhe mbështetës 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	6
	- Roje objekti	Teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	5
	- Mirëmbajtës i objektit	Teknik dhe mbështetës 3	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ51	2
4.	<b>DREJTORIA E SHËNDETËSISË</b>				
	- Drejtor i Drejtorisë	Drejtor i drejtorisë komunale 2	Funksionar publik	Y18	1
	- Zyrtar administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ35	1
	<b>Sektori i administratës në shëndetësi</b>				
	- Udhëheqës i sektorit të	Drejtuës i ulët	Grupi i shkencave shoqërore	GJ3	1

	administratës në shëndetësi - Zyrtar i Lartë për shëndetësi  - Zyrtar për shëndetësi  - Zyrtar i lartë ligjor - Zyrtar për financa	Profesional 1  Profesional 2  Profesional 1 Profesional 2	Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë  Grupi i përgjithshëm i shëndetit/mjekësisë Grupi ligjor Grupi i buxhetit dhe financave	GJ27  GJ35 GJ27 GJ35	1  1 1 1
5.	<b>DREJTORIA E ARSIMIT</b> - Drejtor i drejtorisë - Zyrtar i lartë ligjor  <b>Sektori për arsim</b> - Udhëheqës i sektorit për zhvillimin e arsimit - Zyrtar i lartë për arsimin parashkollor dhe fillor - Zyrtar i lartë për arsimin e mesëm të ulët - Zyrtar i lartë për arsimin e mesëm të lartë  <b>Sektori i administratës në arsim</b> - Udhëheqës i sektorit të administratës në Arsim - Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa - Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore - Zyrtar për infrastrukturë dhe menaxhim të objekteve - Zyrtar administrativ  - Zyrtar për paga - Zyrtar i pasurisë - Zyrtar i lartë për teknologji informative	Drejtor i drejtorisë komunale 2 Profesional 1  Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 1 Profesional 1  Drejtues i ulët Profesional 1 Profesional 1 Profesional 2 Profesional 2  Profesional 2 Profesional 2 Profesional 1	Funkionar publik Grupi ligjor  Grupi i arsimit Grupi i arsimit Grupi i arsimit Grupi i arsimit  Grupi i shkencave shoqërore Grupi i buxhetit dhe financave Grupi ligjor Grupi ligjor  Grupi i administrimit të përgjithshëm Grupi i burimeve njerëzore Grupi i ekonomisë Grupi i teknologjisë informative	Y18 GJ27  GJ3 GJ27 GJ27 GJ27  GJ3 GJ27 GJ27 GJ35 GJ35 GJ35 GJ35 GJ35 GJ27	1 1  1 1 1 1  1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1
6.	<b>DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA</b> - Drejtor i Drejtorisë - Zyrtar i lartë për mbështetje ligjore  <b>Sektori për buxhet dhe financa</b> - Udhëheqës i sektorit për buxhet dhe financa - Zyrtar i lartë për buxhet dhe	Drejtor i drejtorisë komunale 2 Profesional 1  Drejtues i ulët Profesional 1	Funkionar publik Grupi ligjor  Grupi i buxhetit dhe financave Grupi i buxhetit dhe financave	Y18 GJ27  GJ3 GJ27	1 1  1 5

	<p>financa</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyrtar i lartë për kontabilitet</li> <li>- Zyrtar për buxhet dhe financa</li> <li>- Zyrtar për financa</li> <li>- Zyrtar i lartë për zotim të mjeteve buxhetore</li> <li>- Zyrtar i pasurisë</li> <li>- Zyrtar i lartë për shpenzime</li> <li>- Zyrtar për të hyra financiare</li> <li>- Zyrtar për arkiv</li> <li>- Asistent për arkë</li> </ul> <p>- Vozitës</p> <p><b>Sektori i tatimit në pronë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i sektorit të tatimit në pronë</li> <li>- Zyrtar i lartë për tatimin në prone</li> <li>- Zyrtar i lartë për shqyrtimin e ankesave</li> <li>- Zyrtar për mbledhjen e tatimit</li> <li>- Zyrtar për tatimin në pronë</li> <li>- Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme</li> <li>- Zyrtar për regjistrim dhe menaxhimin të dhënave të tatimit në prone</li> </ul>	<p>Profesional 1</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 1</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 1</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 3</p> <p>Teknik dhe mbështetës 2</p> <p>Drejtues i ulët</p> <p>Profesional 1</p> <p>Profesional 1</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 2</p> <p>Profesional 2</p>	<p>Grupi i buxhetit dhe financave</p> <p>Grupi i buxhetit dhe financave</p> <p>Grupi i buxhetit dhe financave</p> <p>Grupi i buxhetit dhe financave</p> <p>Grupi i ekonomisë</p> <p>Grupi i buxhetit dhe financave</p> <p>Grupi i buxhetit dhe financave</p> <p>Grupi i arkiv-dokumentacionit</p> <p>Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>Grupi i administrimit të përgjithshëm</p> <p>Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave</p> <p>Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave</p> <p>Grupi ligjor</p> <p>Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave</p> <p>Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave</p> <p>Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave</p> <p>Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave</p>	<p>GJ27</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>GJ27</p> <p>GJ35</p> <p>GJ27</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>GJ43</p> <p>GJ50</p> <p>GJ3</p> <p>GJ27</p> <p>GJ27</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>GJ35</p> <p>Y18</p> <p>GJ27</p> <p>GJ3</p> <p>GJ35</p> <p>GJ3</p>	<p>1</p> <p>3</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>3</p> <p>3</p> <p>2</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p>
7.	<p><b>DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM, TURIZËM DHE INTEGRIME EVROPIANE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtor i Drejtorisë</li> <li>- Zyrtar i lartë ligjor</li> </ul> <p><b>Sektori i ekonomisë dhe turizmit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i sektorit</li> <li>- Zyrtar për ekonomi</li> </ul> <p><b>Sektori për integrim evropian</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i sektorit</li> </ul>	<p>Drejtor i drejtorisë komunale 2</p> <p>Profesional 1</p> <p>Drejtues i ulët</p> <p>Profesional 2</p> <p>Drejtues i ulët</p>	<p>Funksionar publik</p> <p>Grupi ligjor</p> <p>Grupi i ekonomisë</p> <p>Grupi i ekonomisë</p> <p>Grupi i shkencave politike</p>	<p>Y18</p> <p>GJ27</p> <p>GJ3</p> <p>GJ35</p> <p>GJ3</p>	<p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p>

	- Zyrtar i lartë për integrim evropian - Zyrtar për integrim evropian	Profesional 1 Profesional 2	Grupi i shkencave politike Grupi i shkencave politike	GJ27 GJ35	1 1
	<b>Sektori i zhvillimit</b> - Udhëheqës i sektorit - Zyrtar për regjistrimin e bizneseve	Drejtues i ulët Profesional 2	Grupi i ekonomisë Grupi i administrimit të përgjithshëm	GJ3 GJ35	1 2
